

VENDIM
Nr.159, datë 12.3.2022

PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA
PËR ZBUTJEN E EFEKTEVE TË NDIKUARA NGA LUFTA NË UKRAINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë mbështetje financiare, në masën 3 000 (tre mijë) lekë në muaj për një periudhë tremujore, kategoritë e mëposhtme:

a) Familjet dhe individët përfitues të ndihmës ekonomike, të përcaktuar në nenin 7, të ligjit nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;

b) Individët përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në shkronjat “b” dhe “c”, të nenit 8, të ligjit nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;

c) Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;

ç) Individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar;

d) Personat, që përfitojnë pension invaliditeti, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

dh) Personat, që përfitojnë pension familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

e) Personat, që përfitojnë pension pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe masa e pensionit mujor të tyre është më e ulët ose e barabartë me 50% të pagës minimale neto në shkallë vendi;

ë) Kryefamiljarët, që përfitojnë pension pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe përfitojnë kompensim për efekt të rritjes së çmimit të energjisë elektrike, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.565, datë 9.8.2006, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”, nr.238, datë 7.4.2010, “Për një ndryshim në vendimin nr.565, të Këshillit të Ministrave, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike””, nr.8, datë 14.1.2015, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 5 187 429 000 (pesë miliardë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e njëzet e nëntë mijë) lekë dhe do të përballohen, në masën 5 000 000 000 (pesë miliardë) lekë nga buxheti i shtetit dhe 187 429 000 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e njëzet e nëntë mijë) lekë nga buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Mbështetja financiare e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, paguhet çdo muaj, duke filluar nga data 1 prill 2022 deri në datën 30 qershor 2022. E drejta për përfitimin e mbështetjes financiare është deri në datën 30 qershor 2022.

4. Procedura e pagesës së mbështetjes financiare realizohet, sipas legjislacionit në fuqi për pagesat e përfitimeve nga skemat e sigurimeve shoqërore dhe shërbimit social.

5. Mbështetjen financiare e përfitojnë personat e kategorive të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, të cilët kanë të drejtë për përfitim deri në datën 31 mars 2022 dhe kanë të drejtë të marrin vetëm një herë këtë mbështetje financiare pavarësisht se mund të jenë të përfshirë në më shumë se një kategori.

6. Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimi Social Shtetëror bashkëpunojnë për verifikimin e personave që përfshihen në më shumë se një kategori me qëllim shmangien e pagesës së mbështetjes financiare më shumë se një herë.

7. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama